



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.862/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi Kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut Arjan Shatri nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Istogut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.862/2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut Arjan Shatri nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Istogut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Istog, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në Vendvotimin: 0608C/03D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimin, e vendosur si në pikën **-II- të këtij** dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit Anr.862/2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut Arjan Shatri nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Istogut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, për Vendvotimin. 0606C/05D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatit për kuvend Arjan Shatri nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Istogut, në cilën pretendon se në vendvotimin me numër 0608C/03D, ka mospërputhje te rezultatit pasi që ne këtë vendvotim figurojnë 0 vota nga rezultatit përfundimtar i KQZ-së ndërsa në këtë

vendvotim është dashur te figurojnë më shumë vota bashkangjitur me apel është deklarata e familjes që deklararon se ka votuar, ndërsa në vendvotimin 0606C/05D, nga lista e vëzhguesit figurojnë 4 vota ndërsa në këtë qendër sipas rezultatit të KQZ-së figurojnë 2 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit te provave te bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatit për Kuvend Komunal Arjan Shatri nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Istog ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet 0608C/03D, 0606C/05D, në Komunën e Istogut, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimit, të vendosur si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në Rezultatet përfundimtare nga KQZ, të Kandidateve në qendrat e votimit të apeluara kandidati për Kuvend Komunal Arjan Shatri, ka 0 vota, ndërsa sipas deklaratës të votueses të bashkangjitur në apel e që ndërlidhen me këtë vendvotim, është dashur të ketë së paku 1 vote sipas dëshmis që deklarone se ka votuar kandidatin në fjalë mirëpo kjo votë nuk rezultojnë të jetë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratën e votueses andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, te dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidatin e këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm pretendime, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.862/2021 më datën 07.11.2021



Kryesues i Panelit
Burim Ademi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.